



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:236142

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492158

C.nr.543/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.I nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson E.N, avokate në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurës K... nga Prishtina, sheshi ..., me objekt kontesti Kompensim i dëmit, jashtë seance me datë 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia me shenjë C.nr.543/18 për kompensimin e dëmit, e paraqitur me datë 07.12.2018, e paditësit B.I nga Vushtrria, kundër të paditurës K...nga Prishtina, sheshi ..., për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi B.I nga Vushtrria, përmes të autorizuarës së tij, me datë 07.12.2018, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës K... nga Prishtina, sheshi ...

Me datë 07.12.2018, gjykata ia ka dërguar paditësit Vërejtjen që në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 euro.

E autorizuar e paditësit, me datë 13.12.2018, e ka pranuar Vërejtjen për pagesën e taksës për padi, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirimin e paditësit nga pagesa e taksës gjyqësore, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.543/18, me datë 22.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.